

KONKURS

për

ANËTAR TË PAVARUR TË BORDIT TË DREJTORËVE

Në BPB, punojmë me vendosmëri dhe dedikim për të ndihmuar klientët dhe komunitetin ku jetojmë. Si banka më e mirë në vitet 2018 dhe 2019, e zgjedhur nga prestigjiozja "The Banker", ne jemi një nga institucionet financiare më të respektuara, inovative dhe të suksesshme të vendit. Qëllimi ynë strategjik është të mbështesim zhvillimin e ekonomisë dhe bizneseve të Kosovës. Prandaj, ne krijojmë marrëdhënie të shëndosha dhe afatgjata me klientët përmes vlerave tona - besimit, ndershmërisë, integritetit, transparencës, përgjegjësisë dhe komunikimit të hapur.

BPB është në kërkim të anëtarëve për Bordin e Pavarur të Drejtorëve me qëllim të krijimit të një organi efikas për të zbatuar strategjinë afatgjate të bankës dhe praktikatat më të mira të qeverisjes korporative.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për strategjinë e biznesit dhe qëndrueshmërinë financiare të bankës, strukturën dhe praktikatat e brendshme të Bankës, përcaktimin e pozitive kritike, qeverisjen korporative si dhe detyrimet e menaxhimit të rrezikut dhe pajtueshmërisë. Si anëtar/anëtare i/e Bordit të Drejtorëve, funksioni dhe përgjegjësitë duhet të ushtrohen me besim dhe profesionalizëm ndaj bankës dhe aksionarëve. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, janë përgjegjës të sigurojnë që Banka menaxhohet në atë mënyrë që ruan sigurinë dhe qëndrueshmërinë afatgjate, duke marrë parasysh interesat e të gjitha palëve të interesit përfshirë aksionarët, depozituesit dhe palët e tjera të interesit, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi si dhe standardeve mbikëqyrëse.

PËRGJEGJËSITË KRYESORE:

- Mbikëqyrë zhvillimin dhe miratimin e objektivave dhe strategjisë së bankës dhe monitoron zbatimin e tyre;
- Të angazhohet në mënyrë aktive në projektet e bankës dhe të jetë në hap me ndryshimet në sektorin bankar dhe mjedisin e jashtëm, si dhe të veprojë në kohën e duhur për të mbrojtur interesat afatgjate të bankës;
- Të luajë rolin e udhëheqësit në krijimin e kulturës dhe vlerave korporative të bankës;
- Mbikëqyrë zbatimin e kornizës së qeverisjes së bankës dhe e rishikon në mënyrë periodike në mënyrë që të reflektohen ndryshimet që afektojnë bankën, si: ndryshimet në treg, në kornizën ligjore, në strategjinë e bankës, gjurmën gjeografike të bankës, strategjinë e biznesit, etj.;
- Të përcaktoj bashkë me Menaxhmentin e lartë dhe Zyrтарin kryesor për rrezik gatishmërinë e bankës për të marrë rrezik, duke marrë parasysh kornizën rregullative dhe interesat afatgjate të bankës, ekspozimin ndaj rrezikut dhe mundësinë për të menaxhuar rrezikun me efikasitet;
- Mbikëqyrë respektimin politikës së rrezikut, gatishmërinë e Bankës për të marrë rrezik si dhe kufijtë e rrezikut;
- Miraton qasjen dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave kyçe që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës, planet e kapitalit dhe të likuiditetit, politikatat dhe detyrimet e pajtueshmërisë dhe sistemin e kontrollit të brendshëm;
- Të kërkojë që banka të mbajë një funksion të fuqishëm financiar përgjegjës për kontabilitetin dhe të dhënat financiare;
- Miraton pasqyrat vjetore financiare dhe kërkon rishikim të pavarur periodik të linjave kritike;
- Miraton përzgjedhjen dhe mbikëqyrë performancën e Kryeshefit Ekzekutiv, anëtarëve kryesorë të menaxhmentit të lartë dhe drejtuesve të funksioneve të kontrollit;
- Mbikëqyrë qasjen e bankës ndaj kompensimeve, përfshirë monitorimin dhe rishikimin e kompensimit të Ekzekutivit të Bankës dhe vlerësimin nëse është në përputhje me kulturën dhe gatishmërinë e Bankës ndaj rrezikut;
- Mbikëqyrë integritetin, pavarësinë dhe efektivitetin e politikave dhe procedurave të bankës për 'whistleblowing';
- Merr pjesë aktive në rishikimet e performancës së Bordit në tërësi dhe performancës së anëtarëve të veçantë;
- Të jetë dhe të mbetet gjithnjë i/e përshtatshëm për të kryer rolin si Anëtar bordi në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Për më shumë informacion mbi rolin dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve dhe anëtarëve të tij individual, ju lutemi klikoni këtu:

1. Ligji Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.
2. Rregullorja për Qeverisjen Korporative të Bankave

KËRKESAT DHE KUALIFIKIMET KRYESORE:

- Diplomë universitare në Ekonomi, Financa, Juridik ose fusha të tjera relevante. Individët me kualifikim pasuniversitar ose MBA kanë përparësi;
- Njohuri të konsiderueshme dhe të paktën pesë (5) vite përvojë pune lidhur me: strategjinë e biznesit, menaxhimin financiar, menaxhimin e rrezikut dhe pajtueshmërinë, kornizat dhe metodologjitë e qeverisjes korporative, të fituara në role të menaxhmentit të lartë në institucione bankare dhe jo-bankare;
- Në gjendje të dedikojë kohë dhe përpjekje të mjaftueshme për të marrë pjesë rregullisht dhe në mënyrë aktive në mbledhjet e Bordit;
- Person me qasje strategjike dhe inovative si dhe njohuri të gjerë për industrinë bankare;
- Aftësi për të identifikuar sfidat dhe mundësitë kryesore përbrenda zgjidhjeve teknologjike të bankës, dhe të hartojë politika të përshtatshme për të përcaktuar parametrat brenda të cilave duhet të operojë institucioni;
- Demonstron kuptimin e rëndësisë së punës ekipore në suksesin e bordit, duke përfshirë aftësinë për të njohur dhe vlerësuar kontributin e anëtarëve të bordit, stafit dhe palëve të interesuara;
- Afinitet të natyrshëm për të kultivuar marrëdhënie profesionale dhe për të bindur, mbledhur, lehtësuar dhe ndërtuar konsensus midis individëve të ndryshëm;
- Aftësi për të nxitur ndryshime;
- Reputacion kredibil , nivel të lartë të integritetit dhe ndershmërisë;
- Demonstron gjykim të drejtë dhe të pavarur edhe nën presion;
- Flet dhe shkruan rrjedhshëm në gjuhën angleze.

Për një përshkrim të plotë të përgjegjësive dhe kërkesave kryesore, ju lutemi klikoni në linkun e më poshtëm <https://www.bpbbank.com/banka/#karriera>

Profesionistët e interesuar për të kontribuar në suksesin e BPB si anëtar të Bordit Drejtues duhet të dërgojnë një CV në gjuhën angleze në email adresën: boardnominations@bpbbank.com

Data e fundit për aplikim është 28 shkurt 2020.

Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë.

